

DITARI MUJOR

**KORRIK
2025**

MARRËVESHJA PËR SIGURIMET SHOQËRORE MES SHQIPËRISË DHE ITALISË HYN NË FUQI



Nga 1 Korriku 2025 ka hyrë në fuqi marrëveshja dypalëshe mes Shqipërisë dhe Italisë në fushën e sigurimeve shoqërore, duke garantuar mbrojtje sociale dhe njohje të ndërsjellë të periudhave të sigurimit për qytetarët që kanë punuar në të dy vendet. Marrëveshja u mundëson përfitimin e pensionit dhe të drejtave të tjera pa humbur kontributet e derdhura. Deri më tani, mbi 150 shtetas shqiptarë kanë nisur aplikimet për përfitime, ndërsa Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka siguruar infrastrukturën teknike dhe udhëzuesit e nevojshëm për një proces të thjeshtuar dhe të barabartë. Marrëveshja konsiderohet një hap domethënës në mbrojtjen sociale dhe synohet të shërbejë si model për bashkëpunime të ngjashme me vende të tjera.

UNESCO KONFIRMON PROGRESIN SHQIPTAR NË TRASHËGIMINË BOTËRORE

Në Sesionin e 47-të të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, delegacioni shqiptar raportoi përmirësime në menaxhimin e Parkut Kombëtar të Butrintit, Qendrave Historike të Beratit e Gjirokastrës dhe Rajonit të Liqenit të Ohrit (pasuri e përbashkët me Maqedoninë e Veriut). Komiteti miratoi tri vendime që vlerësojnë kuadrot e reja të menaxhimit, investimet në infrastrukturë, përfshirjen e komuniteteve dhe bashkëpunimin ndërkufitar, duke konfirmuar angazhimin e Shqipërisë për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre pasurive. Ministritë përgjegjëse theksojnë se, megjithë progresin, rritja e turizmit kulturor kërkon koordinim të pandërprerë institucional e profesional për të garantuar mbrojtje të vazhdueshme.



ME KINEASTËT PËR STRATEGJINË E RE TË SEKTORIT AUDIOVIZUAL NË SHQIPËRI



U zhvillua një takim i rëndësishëm me kineastët shqiptarë dhe Kryetarin e ri të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, ku u diskutua vizioni dhe hapat konkretë për zhvillimin e sektorit audiovizual në vend. Prioritetet e strategjisë së re përfshijnë transparencën, ngritjen e standardeve profesionale dhe nxitjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare. Me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë nga British Council dhe përkrahjen e ambasadorit britanik Nicholas Abbott, u prezantua rregullorja e re e aplikimit në QKK, që synon thjeshtimin e procedurave dhe rritjen e projekteve cilësore, si dhe mundësitë e Media Desk të Creative Europe për përfshirjen në rrjetet dhe bashkëprodhimet evropiane. Me një qasje gjithëpërfshirëse dhe partneritete të qëndrueshme, sektori audiovizual synon të bëhet një motor zhvillimi ekonomik, diplomacie kulturore dhe përfaqësimi i identitetit kulturor shqiptar.

TRE PROJEKTLIGJE DREJT NJË EKONOMIE EUROPIANE



Në Kuvend u prezantuan tre projektligje të rëndësishme që forcojnë kuadrin ligjor ekonomik dhe afrojnë Shqipërinë me Bashkimin European. Projektligji për ratifikimin e vendimit të CEFTA-s lehtëson tregtinë elektronike, rrit mbrojtjen e konsumatorit dhe nxit bashkëpunimin rajonal. Projektligji për patentat modernizon mbrojtjen e pronësisë industriale dhe nxit kërkim-zhvillimin, sidomos në sektorin farmaceutik. Ndërsa projektligji për markat tregtare përafron legjislacionin me acquis-in e BE-së, duke garantuar një treg më të drejtë dhe funksional. Tre hapa konkretë për një ekonomi moderne, të sigurt dhe të hapur ndaj inovacionit.



Rekord vizitorësh në sitet kulturore gjatë Janar-Qershor 2025

Sitet kulturore në Shqipëri kanë mirëpritur 569,089 vizitorë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 74% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Ky është një tregues domethënës i interesit në rritje për trashëgiminë tonë kulturore dhe potencialit të turizmit kulturor. Pesë destinacionet më të vizituara kanë qenë: Parku Arkeologjik i Butrintit me 105,623 vizitorë, Kalaja e Gjirokastrës me 92,999 vizitorë, Parku Arkeologjik i Shkodrës me 79,885 vizitorë, Muzeu “Gjergj Kastrioti” në Krujë me 74,636 vizitorë dhe Parku Arkeologjik i Apollonisë me 58,059 vizitorë.

TAKIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR PËR RITJEN, BASHKË DREJT TREGUT TË PËRBASHKËT DHE INTEGRIMIT EVROPIAN



Në Shkup u zhvillua Takimin e Ballkanit Perëndimor për Rritjen “Stabilitet, Unitet, e Ardhme”, së bashku me Kryeministrin Edi Rama, u diskutua mbi vlerësimin e Planit të Rritjes në të gjitha shtyllat e tij, me theks të veçantë të turizmi, mbrojtja e konsumatorit dhe nisma “Autostrada” drejt Tregut të Përbashkët. Kjo nismë synon të forcojë lidhjet ndërmjet ekonomive tona dhe tregut të përbashkët rajonal, duke i afruar ato më shumë me tregun evropian. Një moment i rëndësishëm për të çuar përpara agjendën e integrimit rajonal dhe për të ndërtuar një zhvillim ekonomik më të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes.

BASHKËPUNIMI SHQIPËRI-IZRAEL NË EKONOMI, INOVACION DHE TEKNOLOGJI

Mikëpritëm Ministrin e Energjisë dhe Infrastrukturës të Izraelit, Eli Cohen, me të cilin zhvilluam një takim të frytshëm mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fusha me interes të përbashkët. U diskutua mbi nxitjen e investimeve izraelite në Shqipëri, zhvillimin e një ekosistemi ekonomik të qëndrueshëm dhe partneritete konkrete në kërkim dhe zhvillim (R&D), agritech dhe menaxhimin e burimeve ujore. Një tjetër pikë e rëndësishme ishte bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe inovacionit shkencor, përmes shkëmbimeve akademike dhe ndërlidhjes së qendrave kërkimore të të dy vendeve.



ME KRYEPESHKOPIN ANASTAS PËR BASHKËPUNIM NË TRASHËGIMINË KULTURORE DHE ÇËSHTJET SOCIALE

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit zhvilloi një takim me Kryepeshkopin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumenturinë e Tij Joanin, ku u diskutua mbi rëndësinë e aseteve dhe pavarësisë ekonomike në fuqizimin e kapaciteteve misionare të Kishës. Në një bashkëbisedim të hapur dhe frymëzues, u ndanë ide për thellimin e bashkëpunimit, me fokus te trashëgimia kulturore, objektet monumentale, si dhe çështjet humane dhe sociale. Ministri vlerësoi kontributin e deritanishëm të Kishës dhe shprehu angazhimin për të vijuar menjëherë punën mbi projektet në vijim. Takimi u konsiderua si një ndalesë me vlera të thella shpirtërore dhe institucionale.



PËRMBYLLET ME SUKSES RAUNDI I DYTË I NEGOCIATAVE SHQIPËRI-LETONI



Në Riga, Letoni, u finalizua me sukses raundi i dytë i negociatave ndërmjet Shqipërisë dhe Letonisë për marrëveshjen dypalëshe në fushën e sigurimeve shoqërore. Delegacionet, të kryesuar nga znj. Olta Manjani dhe znj. Ineta Tāre, ranë dakord për Marrëveshjen Kuadër dhe atë Administrative, që sigurojnë mbrojtje të ndërsjellë për qytetarët që punojnë në të dy vendet. Marrëveshja pritet të miratohet nga qeveritë dhe parlamentet përkatëse, duke e çuar në 21 numrin e marrëveshjeve të këtij lloji të negociuara nga Shqipëria, prej të cilave 13 me vende të BE-së.

BASHKËPUNIM KULTUROR SHQIPËRI – ITALI PËR MUZEOLOGJINË BASHKËKOHORE



Në kuadër të bashkëpunimit strategjik ndërmjet institucioneve kulturore shqiptare dhe italiane, u zhvillua një takim i rëndësishëm me përfaqësues të lartë nga Muzeu Kombëtar i Arteve të Shekullit XXI, Ministria e Jashtme Italiane, Ambasada Italiane dhe Instituti Italian i Kulturës. Në fokus të takimit ishte shkëmbimi i përvojave në menaxhimin e institucioneve muzeale bashkëkohore dhe ndërtimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm për zhvillimin e Muzeut të ardhshëm Kombëtar të Arteve të Bukura të Shqipërisë. U theksua rëndësia e aksesit në praktikat më të mira evropiane në ekspozim, ruajtje, digjitalizim dhe promovim të artit bashkëkohor, si dhe roli i programeve të përbashkëta të trajnimit dhe shkëmbimit profesional për të ndërtuar një vizion të përbashkët për të ardhmen e kulturës.

SHQIPËRIA, PËR HERË TË PARË NË NIVEL TË LARTË NË KONFERENCËN E UNCTAD PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT!

E përfaqësuar nga Zëvendësministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, znj. Blerta Rama, Shqipëria mori pjesë në Konferencën e 9-të të UNCTAD në Gjenevë, një forum i rëndësishëm global që promovon zhvillim të qëndrueshëm dhe të drejta të mbrojtura për konsumatorët. Ky angazhim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të standardeve ndërkombëtare për politikat konsumatore në vend.



SHQIPËRIA ME PJESËMARRJE HISTORIKE NË WIPO

Për herë të parë, Shqipëria organizoi një Side Event zyrtar në Asamblenë e Përgjithshme të WIPO në Gjenevë, duke prezantuar trashëgiminë kulturore dhe produktet me Tregues Gjeografik përballë publikut ndërkombëtar. Në këtë kuadër, u nënshkrua edhe Traktati Ndërkombëtar për Dizajnin Industrial, një hap domethënës për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në vend. Gjatë qëndrimit në Gjenevë, u zhvillua një takim bilateral me Drejtorin e Përgjithshëm të WIPO-s, z. Daren Tang, ku u theksua përkushtimi për thellimin e bashkëpunimit institucional. Nën drejtimin e znj. Maria Solis Kapedani dhe me mbështetjen e MEKI, Shqipëria u prezantua denjësisht në një moment historik për afirmimin e identitetit tonë kulturor në skenën ndërkombëtare.





INOVACIONI SHQIPËRI NË RRUGË DREJT BE

Së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe përfaqësues të sektorit të teknologjisë, inovacionit dhe start-up-eve, u diskutua për rrugën e bërë dhe sfidat që pret Shqipërinë në integrimin dhe zhvillimin brenda Bashkimit European. Për MEKI, prioritet mbetet zhvillimi i ekosistemit të inovacionit, përmes bashkëpunimit mes institucioneve publike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Fokus i veçantë është forcimi i kuadrit ligjor dhe mbështetja e sipërmarrjeve inovative, si dhe përfshirja në rrjetet europiane. Po finalizohet ligji bazë për inovacionin, së bashku me legjislacion për byrotë e kreditit dhe crowdfunding, për të lehtësuar aksesin në financim dhe për të nxitur transformimin teknologjik në vend

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE SHËNOJNË REKORD HISTORIK NË TREMUJORIN E PARË 2025

Investimet e Huaja Direkte arritën nivelin më të lartë të regjistruar ndonjëherë për periudhën Janar - Mars, me një fluks prej 362 milionë euro. Ky rekord reflekton rritjen e besimit të investorëve të huaj në klimën ekonomike të Shqipërisë dhe potencialin që ofron vendi. Turqia, Holanda, Italia, Austria dhe Gjermania kryesojnë listën e investorëve, ndërsa sektorët me më shumë investime janë pasuritë e paluajtshme, financa dhe sigurimet, industria nxjerrëse, përpunimi dhe tregtia. Një sinjal i fortë për stabilitetin dhe atraktivitetin e ekonomisë shqiptare.



KOMITETI DREJTUES I PROJEKTIT EU4CULTURE, VIJON PUNA PËR TRANSFORMIMIN E INFRASTRUKTURËS KULTURORE



Në takimin e radhës të Komitetit Drejtues të projektit EU4Culture, ku u diskutua mbi ecurinë e ndërhyrjeve në disa prej objekteve kryesore të trashëgimisë kulturore. Në fokus ishin punimet në Muzeun Historik Kombëtar, hapja e Hamamit të Durrësit, përfundimi i restaurimit të Kalasë së Bashtovës, riorganizimi i Muzeut Arkeologjik të Durrësit dhe kalendari i përbashkët i aktiviteteve kulturore në sitet përfituese. MEKI thekson rëndësinë e përfundimit cilësor dhe në kohë të këtyre ndërhyrjeve, në bashkëpunim të ngushtë me Delegacionin e BE-së dhe UNOPS, duke i kthyer këto hapësira në qendra të gjalla të komunitetit dhe kreativitetit.